



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:144409

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05683918

P.nr.410/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me procesmbajtëse Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit M. M., për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2978/23, të datës 15.08.2023, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar të hapur për publikun, të mbajtur me datë 13.05.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Menduhi Kastrati, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av. J. O., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me date 14.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

M. M., nga i ati I. e ëma H., e gjinisë B., i lindur më ..., në fshatin Ll. e P., ndërsa me vendbanim në fshatin S., Komuna P., me numër personal të identifikimit ..., pensionist, ka të kryer katër (4) klasë të shkollimit fillor, i martuar, baba e pesë (5) fëmijëve, i gjendje së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me parë e në vazhdimësi deri me datën 29.6.2023 ne fshatin S. i E. Komuna e P., me dashje dhe vetëdije e ne kundërshtim me nenin 4 te ligjit 05/L-022 për Armë, pa autorizim posedon arme zjarri në atë mënyrë që pandehuri me herët e deri me datën e lartcekur pa autorizim ka mbajtur ne posedim arme te llojeve te ndryshme ashtu qe me rastin e zbatimit te urdhër kontrollit te Gjykatës tek i njëjti janë gjetur dhe sekuestruar armët dhe atë ... revole te shkurta, një arme te gjate ajrore, ... fishek, ... krehër te karikatorit për arme te gjata, ... kuti e mbushur me barot dhe ... sasi e predhave sferike për fishek te armës se gjuetisë.

- me këtë ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70 të KPRK-së, si dhe të neneve 242, 364, 365, 367, 452 par. 4 të KPPRK-së të pandehurin e:

GJYKON ME KUSHT

I. Ashtu që i cakton Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale.

II Gjykata e liron të pandehurin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale, ngase i njëjti është Invalid i Viktimave Civile të Luftës në Kosovë, dhe se pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të tij ose të personave që detyrohet t'i mbështes materialisht.

III. KONFISKOHEN ... (...) armë revole modeli ... , me nr. serik ... , ... (...) armë revole, me nr. serik ... , ... (...) pushkë e gjatë modeli B... , me nr. serik ... , ... (...) fishekë të armës ... cal. ... mm, ... (...) fishek ... , ... (...) krehër të karikatorit për arme te gjata, ... (...) kuti e mbushur me barot dhe ... (...) sasi e predhave sferike për fishek te armës se gjuetisë, si mjete të kryerjes së veprës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP/II.nr.2978/23, të datës 15.08.2023, kundër të pandehurit M. M., për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.05.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPPRK-së, të njëjtit i ofroi mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka shprehur keqardhje dhe pendesë, është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, nga gjykata kërkoi një dënim sa më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimit të fajësisë nga i njëjti, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që ky pranim i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 242 të KPPRK-së, andaj me rastin e matjes së dënimit, gjykata të merr parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, moshën e tij të shtyrë.

Mbrojtësi i të pandehurit M. M. av. J. O. lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës, andaj gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykatës i propozoi që si rrethana lehtësuese për të pandehurin të merr parasysh pranimin e fajësisë nga i njëjti, moshën e tij të

shtyer, gjendjen e dobët ekonomike të tij, shëndetin e tij, nga gjykata kërkoi që të njëjtit t'i shqiptojë një sanksion më të butë penal, në rastin më të favorshëm dënim me kusht.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur, sjelljen korrekte të tij në gjykatë, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë veprë tjetër penale, moshën e tij të shtyer, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj mbi bazën e arsyeve dhe rrethanave të sipër theksuara gjykata vlerësoi se dënimi me kusht si dënim alternativ i shqiptuar të pandehurit është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 të KPRK-së, i cili konsiston në risocializimin e të pandehurit me anë të pezullimit të dënimit, me të cilin dënim të pandehurit seriozisht i tërhiqet vërejtja dhe i bëhet me dije se nëse i njëjti kryen veprë tjetër penale brenda periudhës së verifikimit të përcaktuar si në pikën (I) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Vendimi mbi mundësinë e revokimit të dënimit me kusht është marrë në bazë të nenit 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi lirimin e të pandehurit nga detyrimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në bazë të nenit 452 par. 4 të KPRK-së dhe nenit 8 pika 8.1.5 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të nenit 366 par. 3 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 242 dhe 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr. 410/23, Datë 14.05.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.